

V E N D I M
Nr. 19, datë 28.1.2002

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË IDENTIFIKIMIT TË KAFSHËVE
DHE TË REGJISTRIMIT TË FERMAVE BLEGTORALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8702, datë 1.12.2000 “Për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit kombëtar të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale është Drejtoria Veterinare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij autoriteti të përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit (shërbimi veterinar) drejtojnë dhe zbatojnë, për çdo zonë që ato mbulojnë, sistemin e identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale nëpërmjet kontratave që do të lidhin me specialistë dhe teknikë privatë, veterinerë dhe zooteknikë.

3. Specialistët e kontraktuar privatë, për punën e kryer, të paguhen nga fermerët me 100 (një qind) lekë për çdo kafshë të matrikuluar dhe plotësimin e formularëve respektivë.

4. Blerja e bazës materiale të nevojshme për fillimin e kësaj veprimtarie të përballohet nga programi PHARE, sipas memorandumeve financiare AL 9805, datë 28 tetor 1998 dhe AL 9912, datë 24 nëntor 1999. Fermerët të paguajnë bazën materiale për krijimin e fondit kundërparti, i cili të depozitohet në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të përcaktojë çmimin e bazës materiale që do të paguajnë fermerët, në bazë të ofertës financiare të entit furnizues të kontraktuar.

Fondi kundërparti të përdoret për blerjen në vazhdimësi të materialeve për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, sipas udhëzimit përkatës, të hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

5. Organet e qeverisjes vendore dhe, sipas nevojës, institucionet publike bashkëpunojnë dhe mbështesin drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit për zbatimin e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta